

L I G J
Nr.8472, datë 8.4.1999

**PËR RIKTHIM NË SHOQËRITË HUMARRËSE TË VLERAVE FINANCIARE TË
PËRFITUARA NGA ANA E PERSONAVE FIZIKË E JURIDIKË NGA SHITJA E
PASURISË APO TRANSAKSIONEVE TË PRONËSISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Fusha e veprimit të ligjit

1.1. Ky ligj u jep të drejtën administratorëve të kryejnë veprimet për rikthimin e vlerave financiare të përfituara në mënyrë joligjore apo në mashtrim, nga persona fizikë e juridikë, të cilët kanë shitur pasuritë e tyre apo kanë kryer transaksione të shitblerjes së pronësisë, subjekteve të ligjit nr.8227, datë 30.7.1997 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë””.

1.2. Përcakton rregullin dhe procedurat që do të zbatohen nga administratorët për kthimin nga personat fizikë e juridikë të vlerave financiare të përfituara nga shitja e pronave, mbi çmimet e privatizimit apo çmimi mesatar përkatës i shitjes në tregun e lirë, me qëllim realizimin e vlerave financiare për shpërndarje kreditorëve.

Neni 2

Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji:

a) “Çmimi i privatizimit” nënkupton çmimin e blerjes së objektit nëpërmjet tenderit, ankandit ose me të drejtën e parablerjes nga ana e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit ose të degëve të saj në rrethe.

b) “Çmimi i shitjes” nënkupton çmimin e shitjes së objektit nga ana e pronarit, sipas kontratës së shitjes dhe regjistrimit të tij në regjistrin e transkriptimeve, subjekteve të ligjit nr.8227, datë 30.7.1997 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë, jo bankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë””.

c) “Transaksione të shitblerjes” nënkuptohen veprimet juridiko-civile e tregtare të kryera në shitblerjen e pronave shoqërive huamarrëse nga ana e personave fizikë a juridikë, me çmime më të larta se çmimi i privatizimit ose çmimi mesatar përkatës i shitjes së tyre në tregun e lirë.

ç) “Vlerë për kthim” nënkupton diferencën në vlerë midis çmimit të privatizimit të objektit apo çmimit mesatar të tyre në tregun e lirë dhe çmimit të shitjes shoqërisë huamarrëse.

d) “Veprim në mashtrim” nënkupton veprimet e kryera nga ana e personave fizikë dhe juridikë në kuptim të nenit 1 të këtij ligji.

Neni 3

Rikthimi i vlerave financiare

Personat fizikë dhe juridikë, vendas a të huaj, të cilët, nëpërmjet fitimit të pronësisë nga

privatizimi apo me mënyra të tjera, kanë përfituar vlera financiare a pasurore nga subjektet e kontrollit a personat e lidhur me ta, nëpërmjet kryerjes së veprimeve juridike të shitjes së pronave me çmime më të larta se çmimi i privatizimit apo se çmimi mesatar përkatës i shitjes në tregun e lirë, detyrohen t'ia kthejnë ato administratorëve të shoqërive huamarrëse.

Neni 4

Personave fizikë e juridikë apo personat e lidhur me ta, veprimet juridike të të cilëve në shitblerjen e pronave me subjektet e kontrollit shpallen të pavlefshme nga gjykata në bazë të neneve 92 dhe 94 të Kodit Civil, kthejnë pranë administratorit shumat apo sendet e përfituara ose kthejnë kontratën në çastin fillestar të saj.

Neni 5

Identifikimi i personave

5.1. Identifikimi i personave fizikë e juridikë që kanë kryer shitblerjen e pronave apo transaksione të pronësisë me shoqëritë huamarrëse, kryhet nga administratorët e caktuar në kuptim të ligjit nr.8227, datë 30.7.1997 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

5.2. Organet shtetërore detyrohen të vënë në dispozicion të administratorit gjithë dokumentacionin që ata kanë për shoqëritë huamarrëse, me qëllim që nga ana e tyre të kryhen veprimet e verifikimit të të dhënave apo vlefshmërisë së tyre.

Neni 6

Administratorët, në përfundim të procesit të identifikimit dhe të shpalljes së pavlefshmërisë nga gjykata, marrin vendim për personat fizikë e juridikë, subjekte të këtij ligji, të cilët duhet të kthejnë vlerat financiare në kuptim të nenit 3 dhe 4 të këtij ligji. Ky vendim përbën titull ekzekutiv.

Neni 7

Përmbushja e detyrimit

7.1. Personat fizikë dhe juridikë, kundrejt të cilëve administratori ka marrë vendim, detyrohen të përmbushin vullnetarisht detyrimin kundrejt subjekteve të kontrollit, brenda 60 ditëve nga data e marrjes së njoftimit

7.2. Administratori, kur personi fizik e juridik, kundrejt të cilit është marrë vendimi, nuk përmbush vullnetarisht detyrimin, ia paraqet atë zyrës së përmbuarimit, në juridiksionin e së cilës ai ka vendbanimin.

7.3. Në përputhje me nenet 609 dhe 610 të Kodit të Procedurës Civile, personat, ndaj vendimeve të administratorit dhe veprimeve të përmbuaruesit, kanë të drejtë që brenda 10 ditëve ndaj vendimit të administratorit dhe 5 ditëve ndaj veprimeve të përmbuaruesit, të bëjnë ankim në gjykatën e apelit, e cila i shqyrton ato brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së ankesës.

7.4. Zyra e përmbuarimit, për ekzekutimin e vendimit të administratorit, zbaton të gjithë rregullat e Kodit të Procedurës Civile dhe vendos sekuestro mbi pasurinë e personit fizik a juridik, në atë masë sa është vlera e detyrimit ose mbi sendin objekt detyrimi.

Neni 8

Pasuritë e vëna në sekuestro vihen në shitje nga administratori i shoqërisë huamarrëse

sipas dispozitave të përcaktuara në ligjin nr.8381, datë 30.7.1998 “Për mënyrën dhe procedurën e shitjes së pasurive të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2352, datë 16.4.1999 të Presidentit të Republikës të Shqipërisë,
Rexhep Meidani**